



Planuar / Doretuar Prijmljena/Prodato Received/Delivered	29.08.2023	3	viti god year
Organ /Jesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSAUK	5848/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1012/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1012/2023 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] nga f.sh. [redacted], Komuna e Vushtrrisë, kundër Vendimit me numër KD.Nr.34/2023 të datës 20.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1012/2023 e datës 19.07.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KD.Nr.34/2023 i datës 20.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit, [redacted] punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Kontratës me numër KI.11/5015422 për kohë të pacaktuar të datës 15.07.2023, në pozitën e punës "Zyrtar Korrektues" në Burgun e Sigurisë së Lartë, me datë 30.05.2023, Mbikëqyrësi i Burgut të Sigurisë së Lartë ka parashtruar kërkesën me numër KD/034 për iniciimin e procedurës Disiplinore pranë Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Më datë 20.06.2023 Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerrë Vendim me numër KD.Nr.34/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore „*ndalimi i 20% e pagës për periudhë një (1) muaj*”.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KD.nr.34/2023 të datës 20.06.2023 të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 19.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1012/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilën kërkon nga Këshilli që të nxjerr Vendim meritore dhe ta obligoj Shërbimin Korrektues të Kosovës që ta anuloj Vendimin dhe mjetet e ndaluara nga paga të rimburohen.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 25.07.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 01.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5303/2023 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.34/2023 të datës 20.06.2023; Fletë kthese me numër evidence: KD.nr.034/23 të datës 22.06.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 01.08.2023; Kontratë pune për kohë të pacaktuar me numër KI 1175015422 e datës 15.07.2020; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 03.01.2023; Ftesë për intervistë e datës 12.06.2023; Procesverbal i datës 16.06.2023; Procesverbal i datës 15.06.2023; Kartela personale e dosjes me numër personal MD/PK/2060; Shkresë e Njësitit për Transportin e të Burgosurve e datës 11.05.2023; Raporti i hyrjes dhe daljes nga puna i datës 12.05.2023; Kërkesë për përcjelljen e të paraburgosurve e datës 11.05.2023; Inicimi i Procedurës Disiplinore me numër Nr.663 i datës 29.05.2023; E-mail i datës 26.05.2023; Deklaratë e L.H; Deklaratë e D.B e datës 22.05.2023; Deklaratë e F.S e datës 22.05.2023; Raporti i aksidentit me numër Nr.2023-TR i datës 12.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e *pa bazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.nr.34/2023 të datës 20.06.2023 të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, pretendon që Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „*ndalimi i 20% e pagës për periudhë një (1) muaj*”, nuk e ka pasur parasysh aspak anën humane por vetëm aspektin e dëmtimit të zyrtarit me ç ‘rast i është shkaktuar dëm financiar, stres dhe rënje e moralit me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi nga ana e Komisionit Disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, ka konstatuar se më datë 12.05.2023 ankuesi është caktuar në një detyrë përcjellje humanitare nga Burgu i Sigurisë së Lartë për në Qytetin e Pejës, ndërsa pas kthimit në autostradën në drejtim të Podujevës afër fshatit Mazgit, në bazë të Raportit Policor me numër 2023-TR-213 të aksidentit të datës 12.05.2023, ankuesi ka shkaktuar aksident me automjetin „Nissan-Patrol i vitit 2009” me numër të targave 37-3222-05 ku sipas detajeve të aksidentit i njëjti nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes në raport me kushtet atmosferike si dhe kushteve teknike kështu që drejtuesi i automjetit në këtë rast ankuesi ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe si pasojë e këtij aksidenti është shkaktuar edhe dëmi material.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh provat materiale të lëndës dhe dispozitat ligjore në fuqi, konstaton se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të nenit 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: „2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.” 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përfundimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”, si dhe nenit 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se „Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit”, sepse zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij, andaj në rastin konkret ankuesi duke qenë shofer i automjetit zyrtar nuk e ka lajmëruar mbikëqyrësin e përcjelljes se ka vështirësi që ta ndjek automjetin e parë në të cilin ka qenë personi të cilit i është dashur ti ofrohet siguri gjatë përcjelljes dhe gjithashtu sipas Raportit Policor me numër 2023-TR-213 të datës 12.05.2023 i njëjti shpejtësinë e automjetit nuk e ka përshtatur me kushtet atmosferike dhe të rrugës, me ç’rast ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe ka shkaktuar aksident në komunikacion dhe si pasojë e këtij aksidenti është shkaktuar edhe dëmi material gjegjësisht me veprimet e tij ankuesi i ka shkaktuar dëme materiale institucionit , rrjedhimisht Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazë të kësaj gjendje faktike, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër KD.nr.34/2023 i datës 20.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit, është në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: “1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”, ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 ku përcaktohet se: “Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”, rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen

faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 50 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafin 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në këtë kuptim, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Vendimi me numër KD.nr.34/2023 i datës 20.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës është i ligjshëm kështu që pretendimet ankimore të ankuesit, janë të pabazuara.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1012/2023

Kaltrina Aydullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit .
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

